

Deklaratë

Me qëllim të mbajtjes së suksesshme të zgjedhjeve lokale më 22 tetor 2017, avancimit demokratik dhe konsolidimit të institucioneve të Kosovës, si dhe

Në përputhje me ligjin për Zgjedhjet Lokale dhe Kodin e Mirësjelljes (rregulloren zgjedhore me nr. 11/ 2013), Grupi për Ballkan u bën thirrje subjekteve politike, kandidatëve dhe koalicioneve, që:

Të angazhohen për mbarëvajtjen e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe demokratike;

Të zhvillojnë fushatë dinjitoze, në kuadër të normave demokratike pa përdorim të gjuhës së urrejtjes dhe duke respektuar njëri tjetrin;

Të respektojnë rezultatet e zgjedhjeve dhe zbatimin e tyre;

Të respektojnë ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Zgjedhjet e përgjithshme të 11 qershorit ishin të lira, të ndershme dhe demokratike. Ato ishin ndër më të mirat të zhvilluar ndonjëherë në Kosovë, u tha në raportet e monitoruesve vendorë e ndërkombëtarë.

Lehtësuar nga Grupi për Ballkan, më 1 qershor 2017, subjektet politike miratuan Deklaratën e përbashkët për zgjedhje të lira, të ndershme dhe demokratike. Ato u angazhuan që zyrtarët partiakë, kandidatët, partnerët dhe koalicionet e tyre të respektojnë përmbajtjen e kësaj Deklarate dhe të parandalojnë secilin veprim që bie ndesh me këto parime.

Në linjë me zotimin e bërë në qershor, Grupi për Ballkan pret që edhe në zgjedhjet lokale, të respektohen parimet e Deklaratës së nënshkruar për zgjedhje të lira, të ndershme dhe demokratike.

Grupi për Ballkan fton organizatat vendore e ndërkombëtare për monitorimin e zbatimit të këtyre parimeve dhe gjithë procesit zgjedhor. Gjithashtu, ftohet KQZ-ja që të insistojë në respektimin e parimeve të kodit të mirësjelljes, si gjatë fushatës zgjedhore ashtu edhe në ditën e zgjedhjeve.

Zgjedhjet e lira dhe të ndershme, si dhe njohja e rezultateve zgjedhore avancojnë konsolidimin dhe funksionimin demokratik të institucioneve lokale në vend.